



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 3 dhjetor 2025

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”

Vlerësimi i përgjithshëm: 84/100

Pergjithesisht pozitiv

A) Informacione te pergjithshme mbi procesin

Emertimi i propozimit te politikës	Projektligji “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.
Ministria udheheqese	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Numri/data e RIAs	2025 – MSHMS – Nr.2
Statusi	Finale
Data e marrjes per shqyrtim	13 nëntor 2025
Data e komenteve te fundit	27 nëntor 2025
Numri i komenteve te kryera/te reflektuara	34/37
Numri i ripunimeve	2

A) Konteksti i politikës

Kjo nismë synon garantimin, mbrojtjen dhe promovimin e arritjes së barazisë gjinore jo vetëm *de jure* por edhe *de facto*, si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë.

Qellimi i kësaj nisme është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për kujdesin alternativ në familje për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për të humbur këtë kujdes, si një nga format e përkujdesit alternativ ndaj fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë.

B) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtorja vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtorja vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar

C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë *plotësisht* në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të thellohet më tej analiza ekonomike (kosto/përfitimi), për të gjitha grupet e prekura. Analiza financiare e paraqitur është në përgjithësi e vakët dhe mungon një analizë e thelluar e përfitimeve, pasi ajo bazohet në supozime.
2. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.